



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 205, datë 05.10.2018

PËR
MARRJEN E MASËS ADMINISTRATIVE NDAJ SHOQËRISË SË BROKERIMIT
“DEVON” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 21) të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 249, pikës 1), germa e) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të nenit 217, pika 3, të Ligjit 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të nenit 3, pika 3, të Rregullores nr. 2, datë 25.01.2016 “Për formën, afatet dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, raporteve statistikore dhe raportimeve të tjera të ndërmjetësve në sigurime dhe risigurime”, e ndryshuar, shoqëria e brokerimit ka detyrimin të depozitojë në Autoritet pasqyrat financiare vjetore, jo më vonë se 3 muaj pas mbarimit të vitit kalendarik, për të cilin po hartohen këto pasqyra dhe pasqyrat financiare 6-mujore, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e përfundimit të periudhës për të cilën po hartohen këto pasqyra.

Ky detyrim si më sipër, nuk është zbatuar nga ana e shoqërisë së brokerimit “Devon” sh.a., si në raportimin e pasqyrave financiare të vitit 2017, po ashtu edhe në raportimin e pasqyrave financiare të 6-mujorit të parë, të vitit 2018.

Për raportimin financiar të vitit 2017, megjithëse ju dërgua me e-mail në datë 20.03.2018, një kujtesë për detyrimin e raportimit brenda datës 31.03.2018, të pasqyrave financiare të vitit 2017, përsëri nga ana e kësaj shoqërie nuk u zbatua ky detyrim ligjor. Nisur nga ky fakt, ju dërgua edhe një shkresë me nr. 1264 prot., datë 06.04.2018, ku i sillnim në vëmendje detyrimin për depozitim në Autoritet të pasqyrave financiare të vitit. Pas kësaj shkrese, si dhe komunikimeve

të tjera me e-mail, dërguan më në fund në datë 13.04.2018 (13 ditë vonesë), me e-mail pasqyrat financiare.

Po kështu, edhe për raportimin e pasqyrave financiare të 6-mujorit të vitit 2018 edhe pse u kujtuan nëpërmjet një e-maili në datë 20.07.2018, për detyrimin e depozitimit brenda datës 31.07.2018, të pasqyrave financiare të 6-mujorit, si dhe u rikujtuan përsëri me e-mail në datë 13.08.2018, nga ana e shoqërisë së brokerimit “Devon” sh.a., pasqyrat financiare janë depozituar në Autoritet vetëm në datë 27.08.2018 (27 ditë vonesë), me shkresën me nr. 2938 prot.

Në bazë të nenit 249, pika 1, germa e) të Ligjit të mësipërm, për këtë shkelje parashikohet sanksion me gjobë.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Bazuar në nenin 249, pika 1), germa e), të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të sanksionohet me gjobë shoqëria e brokerimit “Devon” sh.a. në masën 800,000 lekë.
2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI